



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

RAPORT VJETOR

Drejtuar: Komitetit Drejtues në mbledhjen e datës 16 shkurt 2018
Periudha e Raportimit: Janar 2017 – Dhjetor 2017
Përgatitur nga: Drejtori Ekzekutiv i ShBSh



I. Vështrim i përgjithshëm

Të nderuar anëtarë të Komitetit Drejtues,

Prezantojmë sot para jush në këtë takim të radhës të Komitetit Drejtues (KD) aktivitetet dhe rezultatet e punës së kryer në një hark kohor prej 12 muajsh gjatë vitit 2017.

Në këtë periudhë të raportimit, Shoqata e Bashkive është angazhuar në funksionimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqatës, përfshirë këtu takime të Forumeve Profesionale, komunikimi me anëtarësinë dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë në realizimin e aktiviteteve të ndryshme.

Fokus të vecantë ka pasur dhe aplikimi në programe të ndryshme për fonde të Bashkimit Europian, si dhe zbatimin e aktiviteteve në bashkëpunim me aktorë të tjerë, ku ndër më kryesorët ka qenë bashkëpunimi me NALAS. Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Europën Juglindore. Aktualisht, Shoqata është në zbatim të një projekti me fondet IPA dhe në pritje për të nisur së shpejti dhe dy projekte të tjera.

Ndër zhvillimet për tu theksuar të kësaj periudhe, përmendim rolin oponent dhe unifikimin e zërit dhe interesave tuaja ndaj qeverisë qendrore duke i prezantuar ato për publikun. Përgjatë gjithë vitit, Shoqata është anagazhuar fuqimisht në mbrojtje të interesave të bashkive anëtare përmes prezencës mediatike duke bërë prezent qëndrimin e argumentuar në mbrojtje të decentralizimit dhe të bashkive për çështje mjaft të rëndësishme si shpërndarja e fondeve nga qeveria qendrore, ndërhyrja nga pushteti qendror në çështje lokale si menaxhimi i furnizimit me ujë dhe i menaxhimit të mbetjeve, anashkalimi i pushtetit lokal në shpërndarjen e ndihmës ekonomike, përballimi i situatave të emergjencave civile dhe infrastruktura lidhur me to.

Shoqata ka shfrytëzuar dhe mundësi të takimeve dhe konferencave me donatorë të ndryshëm për t'ju bërë të ditur këto shqetësime.

Ka vazhduar ofrimi i asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të stafëve të bashkive duke lehtësuar dhe mundësuar pjesëmarrjen në takime, seminare dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit në bashkëpunim me aktorë të tjerë apo të organizuar nga vetë Shoqata.

Ky aktivitet ka i ka siguruar Shoqatës një pozicion të konsoliduar si partner i besueshëm në përfaqësim të bashkive.

Pjesë e këtij Raporti është dhe Plani i Aktiviteteve për 2018. Ne kemi planifikuar disa aktivitete të cilat kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen tuaj aktive. Këto aktivitete janë të pasqyruara në Planin për vitin 2018.



II. Aktivitete të realizuara

Më datë 19. 01. 2017 u zhvillua takimi i parë i **Këshillit Konsultativ** mes Qeverisë Qëndrore dhe Pushtetit Vendor. Si dhe jeni në dijeni, Bashkitë në këtë Këshill do përfaqësohen respektivisht nga shoqatat e tyre dhe drejtimi i punës së Këshillit Konsultativ do të jetë me rotacion. Përfaqësuesit e 61 bashkive në Këshillin Konsultativ janë: znj. Voltana Ademi - Bashkia Shkodër, z. Erion Veliaj - Bashkia Tiranë, z. Eduart Kapri - Bashkia Pogradec, znj. Zamira Rami - Bashkia Gjirokastër, z. Xhelal Mziu - Bashkia Kamëz dhe z. Qazim Sejдини - Bashkia Elbasan. Ndërsa qarqet do të përfaqësohen në Këshill nga z. Aldrin Dalipi - Kryetar i Këshillit të Qarkut të Tiranës, znj. Ana Verushi - Kryetare e Këshillit të Qarkut Korçë dhe znj. Greta Bardeli - Kryetare e Këshillit të Qarkut Shkodër.

Gjatë janarit 2017, Shoqata është angazhuar në hartimin e një qëndrimi mbi projekt ligjin për **Financat Vendore**. Janë kryer një sërë konsultimesh me specialistë të bashkive dhe është evidentuar problematika e mëposhtme:

- Projektligji nuk është ezaurues për çështjet e financave vendore, duke bërë referenca të konsiderueshme në elementë mjaft të rëndësishëm sic janë: taksa e pasurisë së paluajtshme, taskat dhe tarifave vendore, procesi i menaxhimit financiar etj.
- Projektligji nuk shënon përparim të konsiderueshëm në decentralizimin fiskal, duke qenë se në pjesën taksave dhe tarifave vendore nuk ka ndryshime thelbësore që do të zgjeronin bazën e taksueshme për bashkitë, duke rritur dhe buxhetin e tyre;
- Taksat e ndara, dhe pse sillen si element i ri, janë pak a shumë përmbledhje të legjislacionit në fuqi më përjashtim të ndarjes së tatimit mbi të ardhurat personale.
- Transfertat e pakushtëzuara për bashkitë, vazhdojnë të mbeten në nivelet aktuale dhe kjo nuk reflekton situatën e vështirë financiare të bashkive me territor dhe kompetenca më të gjera. Ashtu sic është parashikuar, nënkuptohet që kjo shumë e transfertave të pakushtëzuara nuk do të ketë rritje. Një ndryshim i formulimit do të linte hapësira për rritje të transfertës pa bërë ndryshime në ligj.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë vlerëson se **buxheti i miratuar** për qeverisjen vendore për vitin 2017 nuk është koherent me ndryshimet në kuadrin e pushtetit vendor, me reformën administrative-territoriale dhe decentralizimin. Ky buxhet nuk përmbush nevojat tashmë të artikuluara të bashkive e sidomos nuk adreson situatën e hasur në disa prej tyre për shkak të borxheve të trashëguara. Ligji për Buxhetin e vitit 2017 parashikon se buxheti për pushtetin vendor do të jetë në masën 3.1 % e PBB po aq sa ishte gjatë 2016, përkundrejt 2.8% të PBB për vitin 2015 (para reformës). Rritja me 0.3% nga viti 2015 në 2017 është një tregues jo domethënës në mbështetje të shërbimeve publike në nivel vendor krahasuar kjo dhe me kërkesën e Shoqatës së Bashkive që buxheti për 61 bashkitë e dala pas reformës duhet të arrijë në 5% e PBB për vitin pasardhës. Në paketën e Buxhetit për vitin 2017, në total Transferta e Pakushtëzuar rritet me 22% krahasuar me vitin 2016, edhe pse kjo rritje



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

është për tu përshendetur, përsëri është një shifër e pamjaftueshme në raport me nevojat dhe shërbimet që bashkitë ofrojnë.

Në datat 29-31 Janar 2017 u zhvillua konferenca rajonale "**Qytete me Integritet**". Në këtë konferencë, Shoqata u angazhua në panelin e diskutimit për Ndërtimin e Partneriteteve dhe Angazhimin e Aktorëve Lokalë për të diskutuar mbi eksperiencën dhe realitetin e demokracisë lokale në Shqipëri.

Në 28 shkurt 2017, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë mori pjesë në takimin e Grupit të Punës për **Planifikim Urban dhe Infrastrukturë**, organizuar në Beograd Serbi, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe GIZ. Në këtë takim, përfaqësuesi nga bashkitë zoti Qemal Cejku, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Urban u njohën me disa sisteme të lejeve të ndërtimit on - line të aplikuara në disa shtete të Europës Lindore, si dhe problematikën e hasur gjatë aplikimit dhe punën që duhet bërë në të ardhmen për ta bërë këtë sistem funksional dhe i aksesueshëm nga qytetarët. Në këtë takim u prezantua dhe sistemi i planifikimit urban dhe i dhënies së lejeve të ndërtimit në vendin tonë. Në Shqipëri, ky sistem është miratuar me ligj në shtator të vitit 2016 dhe ka qenë funksional prej janarit të vitit 2017. Me gjithë punën që po bëhet, Shqipëria është shumë larg synimit që qytetarët kanë dhe pritshmërive ndaj një shërbimi publik cilësor në zhvillimit urban. Ashtu si këto shërbime ofrohen sot, nuk ka ende një kontroll të saktë sipas specialistëve pasi kemi dublime të mëdha, pra një qytetar aplikon në të njëjtat kushte, për të njëjtin objekt më shumë se 5 herë. Kjo është problematikë mjaft e rëndësishme dhe për ta adresuar qeveria shqiptare duhet të testojë këtë sistem në bashkëpunim me bashkitë përmes Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë kërkon më shumë bashkëpunim që Bashkitë të jenë faktor i rëndësishëm në implementimin e këtij programi. Në konkluzionet e Konferencës u ra dakord që të jetë e shkruar që qeveria shqiptare të ulet dhe të bashkëpunojë me Shoqatat e Bashkive të Shqipërisë për përmirësimin e këtij sistemi dhe çdo gjë që ka të bëjë me zhvillimet urbane në nivel lokal në Shqipëri.

Më datë 17 mars 2017, Shoqata me mbështetjen dhe në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Konrad-Adenauer-Stiftung, zyra Tiranë organizuan një workshop një ditor me temë: "**Qeverisje Vendore e Konsoliduar dhe Decentralizim Real**". Workshopi kishte për qëllim marrjen e mendimeve nga specialistët e bashkive dhe këshilltarët lidhur me vështirësitë që po hasin në zbatim të reformës, të legjisllacionit të ri, funksioneve të reja, decentralizimit, dhe nevojave të qytetarëve për të përmirësuar qeverisjen vendore, si dhe ndërtimi i një platforme idesh për të përmirësuar qeverisjen vendore nesër në funksion të dhënies së shërbimeve cilësore dhe sa më afër qytetarit. Pushteti vendor duhet të qeverisë vetë dhe me qytetarët dhe jo të qeveriset nga pushteti qëndror. Kësaj iniciative e cila fotografon situatën aktuale post reformë në pushtetin vendor ju bashkuan znj. Voltana Ademi, z. Besnik Aliaj dhe z. Besart Kadia.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Në datat 19-24 mars 2017, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në **bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive të Turqisë**, organizuan një vizitë studimore në Stamboll. Vizita pati për qëllim shkëmbimin e eksperiencave në shpërndarjen dhe organizimin e shërbimeve publike, në binjakëzimet ndërmjet Bashkive në Turqi por jo vetëm, në planifikimin urban, etj. Në ditën e parë të vizitës delegacioni nga Shoqata e Bashkive u prit nga Kryetari i Bashkisë Yskydar – Stamboll, z. Hilmi TÜRKMEN. Bashkiakët biseduan për mundësi bashkëpunimi për bizneset turke në turizëm, ekonomi, shfryzimin e burimeve natyrore etj duke siguruar bizneset turke se do të gjejnë të gjitha lehtësirat vendore për zhvillimin e biznesit dhe për cdo partneritet. Kryebashkiaku Yskydarit bashkë me kolegët nga Shqipëria vizituan dhe një qendër sociale, e cila kishte në fokus persona të moshave të ndryshme të prekur nga autizmi. U vu re se sa thjeshtë dhe pa kosto, po me ide mund të angazhohen njerëz me aftësi të ndryshme dhe roli bashkive për të krijuar akses për të gjithë. Në pjesën tjetër të vizitës, bashkiakët ishin të ftuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Zonave të Gjelbra të Bashkisë së Stambollit, ku u njohën me punën dhe strategjitë për gjelbërimin e Stambollit në parqe, lulishte, rrugë etj. me synimin që të arrinin nga 9 m² sipërfaqe të gjelbër për banor në mbi 10m² për banor sipërfaqe e gjelbër në vitet e afërta. Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin Bashkitë: Shkodër, Durrës, Kamëz, Pogradec, Vlorë, Devoll, Gjirokastër, Mat, Klos, Berat, Vau Dejës, Skrapar, Mallakastër, Vlorë, Përmet, Kukës, Kavajë dhe Lezhë.

Më datë 28.03.2017 u zhvillua Konferenca Rajonale me temë **“Qytete sociale gjithëpërfshirëse”** si pjesë e programit të Partneritetit Urban II të Bankës Botërore. Kjo ishte një konferencë rajonale dy ditore e cila u mbajt në qytetin e Zagrebit, Kroaci. Konferenca mbledhi rreth 80 zyrtarë të qeverisjes vendore, shoqatave të qeverisjes vendore, organizatave e shoqërisë civile, sektorit të biznesit dhe aktorët e tjerë kyç për të ndarë njohuritë dhe përvojat e tyre nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova, Kroacia, Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Në panel me kolegë nga rajoni u diskutua mbi ndërtimin e partneriteteve dhe matjen e rezultateve.

Në 31 mars 2017, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Hanns Siedel organizoi në Fier një forum diskutimesh me **administratorët e Njësive Administrative** dhe drejtues të nivelit të dytë të Bashkive. Qëllimi i këtij takimi është ngritja e Forumit të Administratorëve si pjesë e Shoqatës dhe rritja e kapaciteteve ndërevepruese, komunikuese dhe njohurive në disa prej aspekteve kyçe të pushtetit vendor. Paketa e trajnimit fokusohet ndër të tjera në këto çështje: Ligji Organik, të drejtat, detyra dhe përgjegjësitë - Bashkia dhe Njësia Administrative; Organizimi i punës dhe komunikimi - Njësitë administrative dhe Drejtoritë e Bashkive; Të drejtat e njeriut dhe roli i Njesisë Administrative; Shërbimet Administrative. dhe Aspekte nga Kodi i Procedurës Administrative. Në fund të takimit përfaqësuesit zhvilluan zgjedhjen e Administratorëve si anëtarë të Forumit. Ky ishte takimi i parë nga tre takime të organizuara dhe në pjesën tjetër



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

të bashkive, duke siguruar një përfaqësim sa më përfshirës. Takimi i dytë është zhvilluar në datë 20 prill në bashkinë e Lezhës dhe takimi i tretë më 21 prill në Pogradec.

Në datë 7 prill 2017, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Eurovienna, institucion austriak i specializuar në Projekte të Bashkimit Europian dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit për Zhvillim Austriak organizuan Seminarin Informues dhe Trajnues **me koordinatorët e Bashkive për BE**. Qëllimi i këtij Seminari ishte ngritja e njohurive në Bashki për mundësitë e financimit nga fondet e BE dhe njohja me procesin e aplikimit dhe zbatimit të projekteve konkrete me këto fonde. Takimi u lehtësua nga Ekspertët austriakë për Projektet e BE-së, Martin Marek dhe Sophie Deuer – Eurovienna. Ky ekip i trajnuar sot përbën dhe forumin profesional të ShBSh për çështje të BE, por njëkohësisht këto janë një aset i madh për çdo Bashki ku punojnë.

Me datë 9 prill 2017 u zhvillua takimi i **dialogut** midis Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (**CEMR**) dhe **NALAS**-it (Rrjeti i Shoqatave të Qeverisjes Vendore në Evropën Juglindore). Në këtë dialog u vendosën disa platforma bashkëpunimi për:

- Konsultimin mbi instrumentët e ndihmës financiare të jashtme;
- Pozicioni i NALAS "Qeveritë Lokale të Evropës Juglindore që kontribuojnë për Integrim Evropian";
- Dokumenti mbi të ardhmen e Evropës dhe perspektivat lokale dhe rajonale;
- Forumi i Bashkimit Evropian mbi Politikën dhe Zhvillimin;
- Bashkëpunimi me NALAS.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë është anëtare në CMRE dhe NALAS, si përfaqesuese e Bashkive të Shqipërisë.

Më datë 24 prill 2017, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Konrad-Adenauer-Stiftung zyra Tiranë organizuan një Konferencë një ditore me temë: **"Dimensioni Europian i Pushtetit Vendor dhe Instrumentat për Demokraci dhe Decentralizim"**.

Konferenca kishte për qëllim të prezantonte këndvështrimin e dinamizmit të bashkive në vendet perëndimore lidhur me normat, rregullat dhe parimin e subsidiaritë sipas të cilit përgjegjësitë dhe shërbimet publike, funksionet rregullatore dhe shpenzimet duhet të transferohen në nivelin më të decentralizuar institucional apo shoqëror, më të afërt për qytetarët, dhe që është në gjendje ti përmbushin ato; njohje me instrumentat e Bashkimit Evropian si mundësi për bashkitë shqiptare dhe reflektim mbi situatën aktuale dhe sfidat e pushtetit vendor dy vjet pas reformës territoriale.

I ftuar në këtë konferencë ishte deputeti Gjerman i CDU-së z. Thorsten Frei, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman dhe njëkohësisht edhe raportuesi për Shqipërinë. Gjithashtu zoti Frei është njohës shumë i mirë i çështjeve të pushtetit vendor si ish kryebashkiak i qytetit Donaueschingen.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Tematika u fokusua në këto diskutime:

- Situata aktuale në Shqipëri dhe mbështetja nga KAS - Ëalter Glos, Drejtor i Konrad Adenauer Stiftung;
- Eksperienca, roli i bashkive, roli i Bashkimit European në mbështetje të bashkive - Thorsten Frei, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman;
- Si e shikoj unë sot bashkinë & bashkëpunimin ndërinstitucional - Voltana Ademi, Kryetare e ShBSh dhe e bashkisë Shkodër;
- Qasja parlamentare dhe modeli demokrat për pushtetin vendor nesër - Jorida Tabaku, Deputete e Parlamentit Shqiptar
- Reforma territoriale dhe administrative dhe nevojat për hapa të mëtejshme - Dritan Shutina - Co plan.

Më 8 - 11 Maj 2017 u organizua në Londër **Kongresi Global i ËiFi**, ku ShBSh është pjesmarrëse në Bordin Këshillimor të Qyteteve. Gjatë këtij kongresi me rëndësi ishte dhe konferenca "Qytet i ndërlidhur" ku fokusi ishte tek Bashki të Zgjuara ku qytetarëve iu shërbehej me lehtësirat që ofron interneti, Ëifi si dhe puna dhe perfitimet nga gjenerata e ardhshme 5G, ku Bashkitë duhet të bëhen pjesë e këtij sistemi dhe shërbimi. Në këtë kongres ShBSh u përfaqësua me Kryetarin e Bashkisë Kukes z. Bashkim Shehu i cili pati disa takime me drejtuesit dhe organizuesit për mundësi bashkëpunimi dhe ku kërkoi që investime të tilla në teknologji dhe internet në Shqipëri dhe bashkitë shqiptare.

Më datë 18 maj 2017 u zhvillua në Vienë, Konferenca e Ujërave të Danubit e cila adreson sfidat Evropiane dhe Globale të Ujit dhe **menaxhimin e qëndrueshëm të ujit** në axhendën e Kryetarëve të Bashkive të Evropës Juglindore. Zonja Voltana Ademi, kryetare e bashkisë Shkodër dhe zoti Xhelal Mziu, kryetar i Bashkisë Kamëz, morën pjesë në këtë takim. Bashkë me përfaqësues nga institucionet qendrore në Tiranë, ERU dhe SHUKAL u prezantuan sfidat, problematika dhe nevoja për investime të balancuara nga qeveria, investime dhe asistencë nga donatorë. Zonja Ademi në prezantimin e saj vuri theksin në një kordinim më të mirë me të gjithë aktoret si dhe vështirësitë financiare në sigurimin e shërbimit të ujit dhe mungesa investimeve.

Më datë 22 shtator 2017 u zhvillua pranë ambienteve të Shoqatës, një takim me përfaqësues të **Fondit Monetar Ndërkombëtar**, të cilët ofrojnë asistencë teknike për modernizimin e taksës mbi pronen. Krahas takimeve të zhvilluara me aktorët dhe institucionet qendrore, misioni kishte planifikuar dhe realizoi takimin edhe me Shoqatën e Bashkive. Gjatë takimit u diskutuan tema që lidhen me ndarjen e pronave sipas llojit në kadastrat lokale, përfshirë normën e taksimit, vlerën mesatare sipas kategorisë së pronës, të ardhurat nga taksat e pronës për vitet e fundit, si behet faturimi i ketij tatimi, dhe a është miratuar GIS në kadastrën fiskale.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Ndër të tjera u diskutua edhe për impaktin e reformës territoriale, sfidat dhe vështirësitë e Bashkive për të mbledhur taksën e pronës, marrëdhëniet ndërinstitucionale në funksion të performancës më të mirë për çështjen e pronave, lehtësirat burokratike dhe rrugët e mundëshme që prona impaktojë pozitivisht ekonomine e Bashkive.

Më datë 28 – 30 shtator 2017 u zhvillua panairi Citytech 2017 dhe **samiti i Qeverisë Vendore ne Ankara**. Në këtë panair morën pjesë përfaqësues të 10 Bashkive nga Shqipëria - Kavajë, Fier, Mallakastër, Përmet, Durrës, Lezhë, Burrel, Has, Selenicë dhe Kuçovë. Në këtë panair u prezantuan teknologjitë e reja që përdorin Bashkitë Turke dhe ato të vendeve të tjera, në kryerjen e shërbimeve mjedisore, në infrastrukturë, në shërbime sociale, në monitorimin e sistemeve të ujësjellësit, trajtimit të ujërave të zeza etj. Kjo vizitë u realizua në saj të bashkëpunimit të Shoqatës së Bashkive të Turqisë - TDBB me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, ka ndërmarrë iniciativën të ndihmojë disa bashki të përzgjedhura për të përgatitur instrumentin e “**Vetë Vlerësim i Financave Bashkiake** (VVFB) dhe përse është i rëndësishëm ai për Qeveritë Vendore. Për këtë qëllim më dt. 10 - 11 Tetor 2017 me përfaqësuesit e bashkive përfituese që angazhohen në përgatitjen e instrumentit të Vetëvlerësimit Financiar: Kamëz, Roskovec, Kukës, Mat, Mallakastër, Pustec, Selenicë, Devoll, Has, dhe Klos, realizuam trajnimin dy ditor me ekspertët Fran Brahimi, Blerina Xhani dhe Herion Jashari.

Objektivi i trajnimit ishte: Vlerësimi i shëndetit financiar të një bashkie dhe identifikimi i veprimeve specifike për përmirësimin e: (i) të ardhurave nga burimet lokale, (ii) shpenzimeve publike, (iii) menaxhimit dhe mirëmbajtjes së aseteve (te mirave) publike, (iv) planifikimit të investimeve dhe aksesit në financimet e jashtme (huatë dhe financimet nga donatorët). Banka Botërore ka zhvilluar ndër vite një sistem për Vlerësimin e Qeverive Vendore. Ai ka rezultuar një instrument i fuqishëm për përmirësimin e qeverisjes dhe përgjegjshmërisë vendore dhe si dhe në modernizimin e praktikave të menaxhimit. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të Projektit të zbatuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, në bashkëpunim me NALAS dhe me mbështetjen financiare të Programit për Partneritetin Urban i Bankës Botërore Austri, Instituti i Bashkive Bankës Botërore.

Në tetor 2017, Bashkia Kavajë, në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë i bashkohet iniciativave të shumë bashkive në vendet evropiane, po jo vetëm, për organizimin e **Javës Evropiane të Demokracisë Lokale**. Me këtë rast, në bashkinë e Kavajës u organizuan një sërë aktivitete në harmoni me temën e miratuar dhe prioritetin e bashkisë për hapje dhe konsultime me qytetarët. Aktivitetet kryesore ishin:

- “ditë e hapur” në bashki dhe aktivitete që promovojnë pjesëmarrjen qytetare në aktivitetin e bashkisë. Vizita në zyrat e bashkisë, takimi dhe prezantimi të projekteve, sistemit të taksave dhe tarifave, buxhetit, planit zhvillimor, këshilli, dhe kryetari.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- Konferenca “Demokracia vendore”. Organizimi dhe planet e Bashkisë Kavajë. Decentralizimi, Sfida - Subsidiariteti dhe çfarë duhet për më shumë funksionalitet. Roli i qytetarëve në vendimmarrje dhe procesi i konsultimit.
- Rinia dhe roli saj në jetën lokale dhe rajonale. Konkursët ndërmjet shkollave.

I pranishëm në Bashkinë Kavajë, për të ndjekur këto aktivitete të JEDL ishte z. Orlando Fusco Atashe për Qeverisje të Mire pranë Delegecionit të BE në Shqipëri.

Në konferencën “**Vlerësimi i situatës së qeverisjes vendore**”, e zhvilluar më 13 tetor 2017 në mjediset e Tirana International Hotel, në kuadër të projektit “Star”, mori pjesë kryebashkiaku Xhelal Mziu I cili u shpreh periudhës dyvjeçare të reformës administrative - territoriale dhe gjendjes së krijuar prej saj në njësitë vendore, veçanërisht në Bashkinë Kamëz. Duke folur në konferencën “Vlerësimi i situatës së qeverisjes vendore”, z. Mziu renditi sërish problemet dhe shqetësimet e bëra disa herë publike prej tij për sa i përket kësaj shtate. Në qendër të vëmendjes, ishte moskalimi i kompetencave që i takojnë Bashkisë Kamëz, aq shumë të trumbetuara para dy vitesh nga qeveria, si dhe barra financiare më e madhe e njërive vendore, pas ndarjes së re territoriale dhe ndryshimeve të tjera administrative që e shoqëruan atë. Në thelb të diskutimit të tij, kreu i Bashkisë Kamëz pati shtatë kompetencat që duhet t’i kalonin kësaj Bashkie, si është: arsimit parashkollor, mirëmbajtja e rrugëve, pyjet dhe kullotat, zjarrfikëset, qendrat ditore, kolektorët vaditës dhe kullues e shumë funksione të tjera, që duhet t’i siguronin më shumë autonomi qeverisjes vendore, por, në fakt, ka ndodhur e kundërta dhe shembulli më i mirë për këtë është Bashkia e Kamzës, së cilës nuk i është kaluar asnjë kompetencë, përkundrazi, vazhdon e vuan diskriminimin qeveritar të pakuptimtë, për shkaqe politike.

Në zhvillimin e konferencës “Per **reduktimin e rrezikut nga** fatkeqesite dhe roli bashkive”, më datë 18 tetor 2017, morën pjesë perfaqesuesi i Bashkise Shkoder Z. Leonard Mali, i Bashkise Tirane Z. Erind Bejko, perfaqesuesi i MB. Z. Maksimalian Dhima dhe me Z. Lorenc Koci nga UNDP, u diskutuan disa çështje:

- Forcimi i kapaciteteve bashkiake në përgatitjen, përgjigjen, rikuperimin dhe zbutjen e rrezikut ndaj katastrofave, si dhe përfshirjen e tyre në planet, politikat dhe programet e zhvillimit lokal.
- Inkurajimi i dialogut dhe një vendim - marrjeje lokale gjithëpërfshirëse bazuar në shkëmbimin e hapur të informacionit dhe të dhënave mbi rrezikun, të ndara sipas gjinisë, moshës, paaftësisë, lehtësisht të arritshme, të azhurnuara, të kuptueshme dhe të plotësuara nga njohuritë lokale.
- Zhvillimi i programeve dhe projekteve të bashkëpunimit në fushën e parandalimit dhe gadishmërisë për reagim ndaj katastrofave me shoqatat homologe brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Mbështetje për krijimin e sistemeve dhe shërbimeve për shkëmbimin e informacionit, praktikave më të mira, teknologjive, mësimëve dhe masave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- Zhvillimi i fushatave periodike për edukimin dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale mbi rrezikun ndaj fatkeqësive dhe hartimin e strategjive lokale për reduktimin e tyre.

Bashkia Kamëz është përfituese e projektit “Krijimi dhe institucionalizimi i Këshillit Rinor” në Kamëz, mbështetur financiarisht nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe KDZ, ky projekt ka në thelb përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset monitoruese dhe vendimmarrëse të punës së Bashkisë Kamëz, kryesisht Këshillit Bashkiak, lidhur vetëm me çështjet që adresojnë dhe shqetësojnë të rinjtë për të ardhmen e tyre.

Për t’i shërbyer qëllimit të kësaj nisme, e cila në fokus ka angazhimin e të rinjve dhe fuqizimin e rolit të tyre në komunitet nëpërmjet monitorimit të punës së Këshillit Bashkiak si dhe duke u bërë pjesë e proceseve vendimmarrëse në qeverisjen lokale përmes krijimit dhe institucionalizimit të Këshillit Rinor Bashkiak. Kjo iniciativë e organizatës CEID - Qendra për Integrim European dhe Zhvillim dhe Shoqatës së Bashkive është pritur mirë dhe ka angazhimin shumë të mirë të bashkisë që fton të gjithë të rinjtë e Kamzës të behen pjesë aktivë të këtij këshilli, pjesë aktive në procese dhe vendimmarrje të bashkisë.

Më datë 1 nëntor 2017 në ambientet e Qendrës për Informim të BE u zhvillua ceremonia e Nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mes 12 bashkive dhe PNUD si pjesë e **Programit ReLOaD**. Ky program është një projekt rajonal, i financuar nga Bashkimi European që synon të çoj përpara procesin e integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes forcimit të shoqërisë civile dhe rritjes së pjesëmarrjes aktive qytetare në vendim - marrjen lokale. Në takim ishin të pranishëm kryetarë të Bashkive përfituese nga projekti si dhe përfaqësues të Delegacionit European dhe PNUD në Shqipëri.

Më datë 14 – 15 nëntor 2017, në kuadër të Programit të Partneritetit Urban të Bankës Botërore-Austri, u zhvillua në Shkup “**Dialogu Qytetet me Qytetet**” (C2C) për Financat vendore, Planifikimin Urban dhe Menaxhimin e Tokës. Veprimtaria mbledhi ekspertët bashkiak nga Ballkani Perëndimor dhe disa bashki nga Shqipëria, për të diskutuar sfidat e planifikimit efikas dhe efektiv të financave në nivel lokal, planifikimit urban të integruar përmes zhvillimit të orientuar dhe planifikimit të investimeve kapitale.

U zhvillua në Nëntor 2017 konferenca "Rindërtimi i urave lidhëse ndërmjet qyteteve evropiane dhe pjesëmarrja qytetare **kundër stigmatizimit dhe kufijve social - hapsinor** - roli bashkive". Me këtë tematikë u mbledhem dhe diskutuam në konferencën organizuar nga programi bashkëfinansimit të Evropës për Qytetarët në projektin URGENT - "Rindërtimi Urban: Rrjeti European i Qyteteve" i zbatuar nga ALDA - Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale si dhe Agjencia për Demokraci Lokale (LDA) Mostar. Qëllimi i kësaj nisme është ngritja e vetëdijes lokale për nevojën urgjente për krijimin e lidhjeve të reja ndërmjet banorëve/komuniteteve të lagjeve të marginalizuara dhe atyre qendrore. Në konferencë merrnin pjesë 11 autoritete të tjera lokale dhe organizata të shoqërisë civile nga 10 vende të



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

ndryshme në Evropë, përfaqësuesit e institucioneve evropiane, autoritetet lokale dhe rajonale, shoqatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe qytetarët e thjeshtë për të shkëmbyer njohuri, përvojë dhe praktikë të mirë se si të nxitet dialogu ndërkulturor në mjediset urbane të sotme në Europë ku çdo qytetar të ndjehet i sigurt dhe i barabartë, në marrjen e shërbimeve.

Shoqata e Bashkive mori pjesë në Takimin Rajonal të fillimit të projektit në Shkup, Maqedoni më 12 - 13 dhjetor 2017. Fondi Rajonal i Hapur GIZ për Efiçencën e Energjisë të EJK-së, i porositur nga BMZ - Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, do të mbështesë projektin rajonal me temën "**Mobiliteti i Qëndrueshëm Urban** në Vendet e SEE- Qytete nga Evropa Juglindore së bashku drejt transportit të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë". Qëllimi i projektit është zhvillimi i zgjidhjeve të qëndrueshme, efikase për energji dhe transport të gjelbër për qytetet e EJK-së duke përdorur praktikën e mira nga BE / Gjermania dhe pas Strategjisë së Energjisë së BE-së 2030, si dhe qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm (në veçanti Qëllimi 11 - Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme). Qytetet dhe shoqatat e bashkive nga rajoni i EJK janë të ftuar të jenë partnerë në projekt. Roli i shoqatave do konsistoj në shpërndarjen dhe përhapjen e rezultateve dhe arritjeve të projektit. Forcimi i bashkëpunimit mes këtyre dy rrjeteve - rrjeti i qyteteve dhe rrjeti i shoqatave do të sigurojë një zbatim të prosperueshëm të aktiviteteve. Për Shoqatën e Bashkive mori pjesë në këtë event z. Hajredin Serjani.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore për Europën Juglindore) organizojë Seminarin Kombëtar "**Forcimi i bashkëpunimit mes pushtetit qendror dhe vendor në menaxhimin e migrimit**", në bashkëpunim me MARRI (Rrjeti i Ministrive të Brendshme), më Dhjetor 2017. Ky seminar mbledhi së bashku të zgjedhur vendorë dhe punonjës të bashkive me qëllim identifikimin e pikave të forta dhe të dobta të pritjes dhe asistencës/integrimit të emigrantëve, për të krijuar një model rajonal në të ardhmen e afërt.

Në këtë seminar morën pjesë dhe kontribuan përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe Ministria e Diasporës të cilët siguruan mbështetje dhe bashkëpunim, si dhe Ugo Poli Menaxher Projekti i Qendrave për Migrimin CEI dhe lektore nga Italia. Gjatë seminarit, pjesëmarrësit do të njihen me praktika të mira nga vendet e rajonit dhe do të kenë mundësinë të diskutojnë për problematikat dhe sfidat e këtij procesi. Eksperienca italiane për migrimin dhe kuadri ligjor përkatës: prezantim i shkurtër. Roli i shtetit në pritjen dhe akomodimin e migrantëve: nga pikat e nxehta tek "qendrat e asistencës" dhe tek sistemi i shpërndarjes. Integrimi aktiv i refugjatëve dhe azilkërkuesve në nivel vendor: sistemi italian SPRAR, evoluimi dhe angazhimet aktuale. Partneriteti publik-privat: roli i OJF si partnerë socialë të administratës qendrore dhe vendore.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Në dhjetor 2017, Shoqata ka qenë prezente në disa media të ndryshme për menaxhimin e **situatave emergjente të shkaktuara nga përmbytjet**. U duk pozitiv transferimi i funksioneve të reja tek bashkitë si Bordi i Kullimit, Mbrojtja ndaj zjarreve, Rrugët rurale, Administrimi i Pyjeve, por ky transferim nuk u shoqërua me fondet për të funksionuar normalisht. Pra, u transferuan funksionet por nuk u transferuan mjetet e nevojshme (makina dhe pajisje), ambiente të punës (ndërtesa dhe zyra) apo dhe punonjësit përkatës. U transferuan vetëm funksionet, të cilat ju sollën bashkive vetëm kosto shtesë. Për ushtrimin e tyre, bashkia shpenzoi më shumë nga të ardhurat e veta të limituara. Përveç mjeteve financiare, transferimi nuk u shoqërua dhe me transferim të njohurive, trajnime etj.

Problematika qëndron dhe në atë që bashkitë kanë trashëguar. Këtu kam parasysh investimet e kryera (ura, kanale, rezervuarë) nuk janë kryer në cilësinë e duhur. Këto investime nuk kanë përballuar dot përmbytjet që kanë ndodhur, por janë shkatëruar, ose nuk kanë funksionuar. Aktualisht, investimet në struktura nëntokësore janë shumë të pakta dhe shumë të dobta. Ndërtimet pa kriter dhe mbi objekte që ndihmojnë parandalimin e përmbytjeve kanë dëmtuar funksionimin e këtyre objekteve. Kjo e vë në vështirësi bashkinë dhe shkakton probleme tek qytetarët jo vetëm kur ndodh përmbytja por dhe në kushte optimale të motit. Përmbytjet e përvitshme ndodhin dhe pse prej shumë vitesh nuk është investuar për mirëmbajtjen dhe funksionin e objekteve të cilat eliminojnë përmbytjet, psh nuk është investuar në shtratet e lumenjve, në rezervuarë, në bonifikim, kanalizimin etj.

Gjatë dhjetorit 2017, është kryer një analizë e situatës aktuale dhe një sërë faktorësh vendimtarë për qeverisjen vendore në Shqipëri si pjesë e studimit të kryer nga Shoqata e Bashkive me asistencën e Fondacionit Hanns Siedel në Shqipëri, **Vlerësim i Ushtrimit të Funksioneve të Reja**. Hyrja në fuqi e një ligji të ri organik për pushtetin vendor në Republikën e Shqipërisë solli transferimin e detyrave dhe përgjegjësi të reja për bashkitë në mbrojtjen nga zjarri, sistemin arsimor paraskollor, bujqësi, kullimi dhe kanalizimet, shërbimet sociale, mjedisi, mirëmbajtja e rrugëve rurale dhe pyjet e kullotat.

Ofrimi i këtyre shërbimeve të reja, dhe dy vjet pas reformës territoriale, po has vështirësi të mëdha në bashkitë tona duke mbetur larg standarteve të dëshiruara nga ne dhe qytetarët.

Pas një shqyrtimi të hollësishëm të situatës aktuale, Shoqata e Bashkive vëren se:

- Standardet për secilin funksion duhet të përcaktohen nga qeveria qendrore dhe për më tepër një kosto për secilin standard duhet të llogaritet financiarisht. Kjo do të kërkojë një analizë të thellë për secilin funksion veçmas në mënyrë që të përcaktojë implikimet financiare të një transferimi të tillë.
- Duhet të theksojmë se qeveria qendrore jo vetëm që duhet të transferojë pushtetin, fondet, asetet etj., por edhe burimet njerëzore, njohuritë dhe fondet e nevojshme për t'i ndihmuar bashkitë që të krijojnë kapacitete të përshtatshme për ofrimin e këtij funksioni.
- Drejtoritë e dekoncentruara dhe qeveria qendrore duhet t'u sigurojnë bashkive të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me funksionet e mësipërme, në mënyrë që



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

të mbështesin bashkitë në ngritjen e vetëdijes së tyre si dhe përgjegjësitë e tyre në ofrimin e një shërbimi më të mirë për qytetarët.

- Një decentralizim i kujdesshëm duke marrë parasysh të gjitha implikimet e transferimit të funksioneve të reja në bashki do të forcojë rolin e qeverive vendore në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe rritjen e demokracisë lokale në komunitetet e tyre.

III. Komunikimi me anëtarësinë dhe aktorë të tjerë

Komunikimi ka qenë tepër i mirë dhe efikas me të gjitha mjetet. Shoqata e Bashkive pasqyron aktivitetet, zhvillimet më të rëndësishme në fushën e qeverisjes vendore, si publikon njoftimet dhe aktivitetet në media sociale si Facebook, dhe në faqen e saj të internetit www.aam.org.al. Gjithashtu, dërgojmë paketa të materialeve të nevojshme për t'ju shpërndarë bashkive mbi legjislacionin vendor dhe të tjera.

Që prej muajit mars, Shoqata do të nisë publikimin e Buletinit informativ i cili do të dalë cdo tre muaj dhe do të pasqyrojë veprimtarinë e Shoqatës dhe të reja me interes për bashkitë.

Komunikimi me komunitetin e donatorëve brenda dhe jashtë vendit është në nivele të kënaqshme, në ndajmë me to të gjitha deklaratat, qëndrimet dhe opinionet mbi zhvillimin e pushtetit vendor, mbi padrejtësitë që anojnë nga bashkitë e djathta etj.

Marrëdhëniet me organizatat partnere dhe anëtare janë efektive, edhe pse duhet të kishte më shumë produktivitet, por arsye është fakti që ka një penalizim ngaqë shoqatat janë të ndara politikisht, dhe kjo frymë është më tepër tek partneret dhe donatorët në Shqipëri, ndërsa jashtë vendit jemi të mirë pozicionuar.

Marrëdhënie shumë të mira kemi me NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore në Europën Juglindore), i cili është një mbështetës dinjitoz për ne edhe pse në këto kushte. Me Nalas kemi 5 task forca ku marrim pjesë dhe përfaqësohen thuajse të gjitha bashkitë tuaja.

Me CMRE (Këshilli i Qyteteve dhe Rajoneve Europiane) kemi bashkëpunim të mirë dhe aktivitete të pakta.

Me ALDA (Shoqata e Agjensive të Demokracisë Vendore), kemi bashkëpunim të mirë dhe aktivitete të pakta.

Me Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Europës, jemi korrekt dhe aktivë politikisht me qëndrimet tona, po nuk kemi përfaqësimin që duam dhe kjo për arsye politike.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Shoqata ka përfaqësuesit e saj në çdo bord dhe agjensi apo komitete të përkohshme të projekteve si STAR 2, strategjinë e ujit, etj.

IV. Çështje për tu adresuar

Pa dashur të përsëris fjalët për klimën pozitive të ecurisë së punëve në Shoqatë, dëshiroj t'u paraqes disa shqetësime, me mendimin se do kemi mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj për të përmirësuar sa të jetë e mundur dhe me kontributin e të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues. Këto çështje janë:

- Ushtrimi i funksioneve të reja;
- Menaxhimi i mbetjeve;
- Reforma e Ujit
- Emergjencat Civile;
- Sistemi i ri i taksës së pronës dhe metodologjia.

V. Aktivitete për vitin 2018 (aneks)

Plani i aktiviteteve për vitin 2018 është bashkangjitur këtij raporti për diskutim dhe miratim nga Komiteti Drejtues.

VI. Raporti Financiar

Raporti Financiar për vitin 2017 dhe një raportim i të ardhurave të Shoqatës nga pagesat e kuotës së anëtarësisë janë bashkangjitur në këtë raport.

Faleminderit!

Agron Haxhimali
Drejtor Ekzekutiv